URDHËR
Nr.482, datë 9.11.2004

PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE QË KRYHEN NGA SEKSIONET E ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS NË QARK

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe pikës 13 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.532, datë 31.10.2002 "Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komunë dhe ose bashki", me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit të Tokave,

URDHËROJ:

1.Tarifat e shërbimeve që do të kryhen nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qark do të jenë:

- Vërtetim pronësie para vitit 1946	1000 lekë
- Vërtetim pronësie pas vitit 1946	5000 lekë
- Vërtetim negativ para reformës, për në gjykatë	500 lekë
- Vërtetim pronësie për Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	500 lekë
- Vërtetim pronësie që kërkohet për Statusin të pastrehë	200 lekë
- Konfirmim i vërtetimeve për ndihmë ekonomike e përkrahje sociale të ardhura nga komuna dhe/ose bashkia	100 lekë
- Konfirmim i formularit nr.5 bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.560	500 lekë
- Harta e skica planimetrike – kadastrale	1000 lekë
- Vërtetime për kategorizimin e tokës, sipas bonitetit	2000 lekë
- Dublikatë e aktit të marrjes së tokës në pronësi ose në përdorim	500 lekë

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Agron Duka